

Konferenca e 5-të Ndërkombëtare e Shëndetit Publik, Shqipëri 2017

“Përcaktorët e sjelljeve shëndetësore në vendet e Rajonit European”

Në vitin e saj të pestë, Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik do të zhvillohet në datën 9 maj 2017 në Tiranë, me temë: “Përcaktorët e sjelljeve shëndetësore në vendet e Rajonit European”,

Kjo konferencë e Shëndetit Publik do të adresojë disa çështje kryesore, të cilat kanë të bëjnë me përcaktorët e sjelljeve shëndetësore në shoqëritë në tranzicion, në Ballkanin Perëndimor dhe në vendet e tjera të Rajonit European.

Faktorët kryesorë të stilit të jetesës përfshijnë duhanpirjen, konsumin e alkoolit, përdorimin e drogave, aktivitetin fizik, sjelljen seksuale dhe zakonet e të ushqyerit. Në shkallë globale është vërtetuar se faktorët kryesorë të rrezikut që lidhen me vdekshmërisë përfshijnë duhanpirjen, nivelin e lartë të glukozës në gjak, mungesën e aktivitetit fizik, mbipeshën dhe obezitetin. Të gjithë këta faktorë të modifikueshëm të stilit të jetesës janë gjithashtu përgjegjës edhe për rritjen e rrezikut të sëmundjeve kronike duke përfshirë sëmundjet kardiovaskulare, kancerin dhe diabetin.

Në Shqipëri, tre faktorët e riskut, të cilët mbanin peshën më të madhe të sëmundshmërisë në vitin 2010, ishin faktorët që lidhen me ushqyerjen (i pari), presioni i lartë i gjakut (i dyti), duhanpirja (i treti). Në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, prevalenca e duhanpirjes mund të rritet nëse nuk merren masa paraprake, dhe kjo mund të rrezikojë seriozisht rritjen e mëtejshme të jetëgjatësisë së pritshme dhe rënien e mundshme të barrës së sëmundjeve jo të transmetueshme.

Vendi ku do të zhvillohet konferenca:

Hotel “Tirana Internacional”

Sheshi “Skënderbej” 8, Tiranë

Organizimi

Konferenca Ndërkombëtare e Shëndetit Publik organizohet nga Instituti i Shëndetit Publik me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë.

Komiteti Shkencor	Komiteti Organizues	Sekretaria
Arjan Bregu Genc Burazeri Eduard Kakarriqi Gentiana Qirjako Silva Bino Ervin Toçi Alban Ylli Enver Roshi Jolanda Hyska	Gentiana Qirjako Jolanda Hyska Albana Ahmeti Rudina Çumashi Herion Muja Jonida Canaj	Dritan Roshi Alba Rexha Florida Beluli Besian Elezi

Arben Gjata Suela Këllici Xheladin Draçini Ulrich Laaser, Gjermani Helmut Brand, Hollandë Theodore Tulchinsky, Izrael Joao Costa, Zvicër Charles Hardy, SHBA Greg Evans, SHBA Patricia Brownell, SHBA Juan Schoemaker, USA Jadranka Bozikov, Kroaci Izet Masic, Bosnje-Herzegovinë Vesna Bjegovic, Serbi Doncho Donev, Maqedoni Naser Ramadani, Kosovë Shaban Mehmeti, Maqedoni		
---	--	--

Programi i Konferencës

7.30 -09.00	Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe prezantimi i posterave virtualë	
Hapja e Sesionit të Konferencës së 5-të Ndërkombëtare të Shëndetit Publik		
09.00-09.30	Fjala e mirëseardhjes nga drejtori i Institutit të Shëndetit Publik	Dr. Arjan Bregu
	Fjala përshëndetëse nga Ministri i Shëndetësisë	Z. Ilir Beqaj
	Fjalë përshëndetëse nga Ambasadori i Ambasadës Zvicerane në Shqipëri	Z. Christoph Graf
	Fjalë përshëndetëse nga Koordinator i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara	Përfaqësues i UN-së
	Fjalë përshëndetëse nga OBSH-EURO	OBSH Kopenhagen (TBC)
Sesioni Plenar: Përcaktorët e sjelljeve shëndetësore dhe ndikimi i tyre në shëndet Drejtuesi i sesionit: TBC		

09.30-09.45	Përcaktorët e sjelljeve shëndetësore në Shqipëri	MSH
09.45-10.00	Indikatorët e sjelljes/stilit të jetës të përshtatur për Shqipërinë	ISHP
10.00-10.15	Një qasje përgjatë gjithë ciklit të jetës i përcaktorëve të sjelljeve	Agjencitë e UN-së
10.15-10.35	Qasjet e reja në trajtimin e përcaktorëve të sjelljeve	TPH, Basel
10.35-10.50	Përcaktorët e sjelljeve shëndetësore në vendet e OBSH-së për Europën	OBSH
10.50-11.15	Pushimi kafe dhe prezantimet e posterave të konferencës	
11.15-13.30	SESIONI PARALEL 1 Tema: Perceptimi dhe menaxhimi i peshës trupore dhe aktiviteti fizik, si një përcaktor kryesor i sjelljeve shëndetësore	Moderator: TBC
11.15-13.30	SESIONI PARALEL 2 Tema: Duhanpirja, konsumi i alkoolit, përdorimi i drogave dhe praktika të tjera të varësisë dhe sjelljes.	Moderator: TBC
	SESIONI PARALEL 3 Tema: Seksualiteti, shëndeti, mirëqenia dhe të drejtat e njeriut	Moderator: TBC
11.15-13.30	SESIONI PARALEL 4 Tema: Praktikrat e ushqyerjes së foshnjës dhe fëmijëve të vegjël, ushqyerja e të rriturve dhe modelet dietetike	Moderator: TBC
13.30-14.30	Dreka dhe prezantimi i posterave virtualë	
SESION PLENAR		
14.30-15.30	Raportimi nga sesionet paralele	
15.30-16.15	Hartimi i politikave të bazuara në evidenca	Paneli do të përbëhet nga përfaqësues të MSH-së, ISHP-së, Agjencitë e OKB-së, si dhe ekspertë të tjerë ndërkombëtarë.
16.15-17.00	Bashkëpunimi rajonal dhe përmbyllja	Paneli do të përbëhet nga përfaqësues të MSH-së, ISHP-së, Agjencitë e OKB-së, si dhe ekspertë të tjerë ndërkombëtarë

Përshkrimi i sesioneve paralele

SESIONI PARALEL 1: *Perceptimi dhe menaxhimi i peshës trupore dhe aktiviteti fizik, si një përcaktor kryesor i sjelljes i lidhur me shëndetin.*

Niveli i lartë i masës trupore (BMI) shton rrezikun për një numër sëmundjesh kronike. BMI llogaritet si raporti midis peshës trupore (kg) dhe gjatësisë (m^2). Mbipeshë do të quhet BMI nga 25.0 në 29.9 (kg/m^2), ndërsa obeziteti i referohet BMI ≥ 30 (kg/m^2) (OBSH 2011). Aktiviteti fizik është i vështirë të matet, edhe në studimet e zhvilluara në popullatë. Ai konsiston në ushtrime fizike në punë, në shtëpi, si dhe gjatë kohës së lirë.

Në përgjithësi, shtimi i kohëzgjatjes së aktivitetit fizik sjell përfitime në shëndet pasi ai zvogëlon rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare, depresionit dhe obezitetit, i cili përbën një faktor rreziku më vete.

Perceptimi personal i peshës trupore influencohet gjithashtu nga normat e shoqërisë dhe standardet e kulturave dominuese. Perceptimi i mbipeshës dhe sjelljeve të lidhura me dietën fillojnë të shtohen dukshëm gjatë adoleshencës, kryesisht te vajzat.

Ky sesion do të përfshijë prezantime lidhur me njohuritë dhe evidencat rreth impaktit të perceptimit dhe menaxhimit të peshës në shëndet, si dhe efektet e dëmshme të mbipeshës, obezitetit dhe inaktivitetit fizik në vendet në tranzicion të Europës Juglindore dhe kudo tjetër.

SESIONI PARALEL 2: *Duhanpirja, konsumi i alkoolit, përdorimi i drogave dhe praktika të tjera të varësisë dhe sjelljes.*

Ka të dhëna të mjaftueshme të cilat e lidhin duhanpirjen me sëmundje të ndryshme jo të transmetueshme, përfshirë sëmundjet kardiovaskulare (sëmundjet ishemike të zemrës dhe aksidentet cerebrovaskulare), kancerin e mushkërive dhe kancere të tjera, si dhe sëmundje të tjera të tilla si Sëmundja Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK). Për këtë arsye, duhanpirja është konsideruar shkaku i vetëm i parandalueshëm i problemeve shëndetësore (OBSH, 2011). Nga ana tjetër, konsumi i alkoolit përfshin jo vetëm konsumin e sasive të tepruara të alkoolit, por edhe modele të dëmshme të konsumit të alkoolit të konsideruara si “*binge drinking* (e pirë e tepruar)”, (e cila konsiston në konsumin jo domosdoshmërisht të sasive të mëdha të alkoolit, por në konsumin e tij për një periudhë shumë të shkurtër kohe; ky model është tipik sidomos për vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, si p.sh. Rusia). Konsumi i dëmshëm i alkoolit tashmë njihet si një faktor rreziku për sëmundjet kardiovaskulare dhe disa lloje kanceri, sidomos për kancerin e pankreasit dhe atë të mëlçisë.

Ky sesion do të përfshijë prezantime të lidhura me punën kërkimore të kryer në vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat kanë dokumentuar prevalencën, shpërndarjen dhe barrën e sëmundjeve të lidhura me duhanpirjen, konsumin e alkoolit, përdorimin e drogës dhe praktika e sjellje të tjera të lidhura me varësinë në vendet e Ballkanit Perëndimor e më gjerë.

SESIONI PARALEL 3: Seksualiteti, shëndeti, mirëqenia dhe të drejtat e njeriut

Gjithkush ka të drejtë të gëzojë standardin më të lartë të shëndetit - një gjendje e plotë fizike, mendore dhe mirëqenie sociale dhe jo thjesht mungesë sëmundjeje ose dobësi.

Seksualiteti është një aspekt kryesor i qenies njerëzore për gjatë gjithë jetës dhe përfshin marrëdhënien seksuale, identitetin dhe rolet gjinore, orientimin seksual, erotizmin, kënaqësinë, intimitetin dhe riprodhimin. Ai ndikohet nga ndërveprimi i faktorëve biologjikë, psikologjikë, socialë, ekonomikë, politikë, kulturorë, etikë, juridikë, historikë, fetarë dhe shpirtërorë.

Sjellja seksuale çon në një shumëllojshmëri pasojash të dëmshme, të tilla si shtatzënia e paplanifikuar, stigma sociale, infeksionet dhe sëmundjet kronike, si dhe çrregullimet psikologjike. Shumë nga këto rezultate negative, të cilat ndodhin në një moshë të re, çojnë në të jetuarin me aftësi të kufizuar për një pjesë të madhe të viteve të jetës. Gratë mbajnë një pjesë të lartë disproporcionale të sjelljes së përgjithshme seksuale që i atribuohet barrës së sëmundjes.

Ky sesion do të përfshijë prezantime të lidhura me njohuritë dhe praktikën për përmirësimin e praktikave të kujdesit në familje dhe ndikimin e mjedisit social për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës; modelet e vizitave shtëpi; seksualitetin dhe të drejtat e njeriut, si dhe barrën e sëmundjes për shkak të sjelljeve seksuale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe gjetkë.

SESIONI PARALEL 4: Praktikën e ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve, ushqyerja në moshën adulte dhe çështje të lidhura me dietën

Faktorët e rrezikut të lidhura me dietën ndikojnë në zhvillimin e sëmundjeve jo të transmetueshme. Studimet GBD (2010) ka evidentuar një listë të zgjeruar të faktorëve të rrezikut të lidhur me dietën që influencojnë në sëmundje kronike, duke përfshirë 14 elemente ushqimore (frutat, perimet, të gjitha drithërat, qumështi, pijet me sheqer, fibrat, mishi i kuq, mishi i trajtuar, farat, kalciumi, soda, prodhimet e detit omega-3, trans-acidet e yndyrshme, dhe polisaturated-acidet e yndyrshme).

Barra e sëmundjes për shkak të faktorëve të rrezikut të lidhur me dietën ishte më e lartë në vitin 2000, pothuajse për të gjitha vendet në Europën Juglindore. Megjithatë, barra e sëmundjes që i atribuohet këtyre faktorëve është ulur në mënyrë të ndjeshme në shumicën e këtyre vendeve, por jo në Shqipëri, ku këto janë faktorët kryesorë të rrezikut.

Ky sesion do të përfshijë prezantime që lidhen me studimet dhe kërkimet më të fundit të zhvilluara sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat tregojnë impaktin e problemeve të dietës në këto vende, ashtu si edhe në vendet e tjera. Për më tepër, prezantimet në këtë sesion do të lidhen edhe me njohuritë dhe praktikën e lidhura me rëndësinë e të ushqyerit të përshtatshëm të fëmijëve si një themel i mirë për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Instruksiione për abstraktet

Abstraktet do të konsiderohen për prezantim oral, ose me poster. Prezantimet orale do të jenë 10 minuta, dhe 5 minuta kohë për diskutim në sesione 135 minutëshe. Individët duhet të regjistrohen për konferencën me anë të abstrakteve që do paraqiten.

Abstraktet nuk janë të kufizuara vetëm mbi temën e konferencës: tema të tjera mbi shëndetin publik dhe shërbimet e shëndetit publik janë të mirëpritura.

Të gjithë abstraktet duhet të dorëzohen me e-mail tek: konferencashp@yahoo.com

Afati i dorëzimit të abstrakteve: 1 Prill 2017.

Aplikantët do të njoftohen për pranimin e abstrakteve të tyre nga data, 15 Prill 2017.

Udhëzimet e Përgjithshme

- Abstrakti duhet të jetë maksimumi 250 fjalë. Mund të pranohen grafikët, tabelat, ose hartat, por duhet të vendosen në fund të tekstit.
- Autorët duhet të para-përcaktojnë zgjedhjen e parë dhe të dytë të paraqitjes së abstrakteve: me gojë kundrejt prezantimeve me poster.
- Titulli i Abstraktit: duhet të jetë i shkurtër, pa shkurtime dhe initiale. Vendndodhja gjeografike dhe koha e studimit duhet përmendur kurdoherë e mundur/nevojshme.
- Autori që prezanton: emri i autorit që prezanton duhet të jetë shtypur i plotë (Emër dhe Mbiemër).
- Përfaqësia: nëse keni një ose më shumë përfaqësi, listoni dhe ju lutem përdorni 1, 2, 3 për radhitjen e tyre.

Struktura e Abstrakteve

Autorët duhet të përdorin nën-titujt e mëposhtëm që të strukturojnë abstraktet e tyre:

- *Qëllimi*: duhet të adresojë historikun dhe arsyetimin shkencor për këtë studim, si edhe domethënien e temës nën studim për shëndetin publik. Autorët duhet të përshkruajnë rëndësinë e studimit, pyetj (-a; -et) kërkimore dhe objektivat e studimit.
- *Metodologjia*: duhet të përshkruajë ndërtimin e studimit, vendin (komunitetin, klinikën, spitalin), pjesëmarrësit në studim, rezultatet e matjeve analitike dhe/ose teknikave ndërhyrëse.
- *Rezultatet*: duhet të paraqesin gjetjet kryesore në të dhëna sasiore dhe cilësore, të shoqëruara me intervalet e konfidencës ose nivelet e domethënies të testeve statistikore, sipas përshtatshmërisë.
Gjetjet “negative” si edhe “pozitive” mund të jenë me interes të barazvlefshëm. Megjithatë, autorët duhet të raportojnë vetëm ato rezultate në lidhje me konkluzionin.

- *Konkluzioni*: autorët duhet të raportojnë vetëm ato konkluzione që janë të mbështetura drejtpërdrejtë nga të dhënat. Autorët duhet të raportojnë veprimet që rekomandohen të ndërmerren në shëndet publik. Sa të jetë e mundur, autorët duhet të theksojnë madhësinë e ndikimit të punës së tyre kërkimore në shëndet publik.

Procedurat e Vlerësimit

- Të gjitha abstraktet e dorëzuara do të rishikohen nga kolegët e Komitetit Shkencor sipas kritereve të mëposhtme: (i) risia dhe përkatësia me punën kërkimore; (ii) metodologjia; (iii) ndikimet për kërkimin dhe praktikën e shëndetit publik.

Stili i tekstit

Abstraktet duhet të shkruhen në Anglisht, Times New Roman, madhësia e shkronjave 12, me hapësirë njëshe.